



Prishtinë: 05.08.2010

Kodi i ZRRE-së: V_264_2010

Nr. i Referencës: ZRRE/DMK_V_432_07_10

Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji

Duke marrë parasysh:

1. Kompetencat e Zyrës së Rregullatorit për Energji të dhëna në nenin 17 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë;
2. Dispozitat sipas Kapitullit 3, Nenit 17 të Rregullës mbi Procedurën e Zgjidhjes së Kontesteve në Sektorin e Energjisë;
3. Dëshmitë e paraqitura nga palët;
4. Vendimin e DMK të ZRRE-së: **ZRRE/DMK_V_432_07_10** ;
5. Apelimi i KEK-ut me datë 26.07.2010;
6. Nenin 18 të Rregullës mbi Procedurën e Zgjidhjes së Kontesteve në Sektorin e Energjisë;

Në mbledhjen e mbajtur më 05 gusht 2010 nxori këtë:

VENDIM

REFUZOHET apelimi i KEK-ut për ankesën e konsumatorit Rasim Xhaferi (shifra e konsumatorit DPZ – 148096) nga Prizreni, si në arsyet e paraqitura të këtij vendimi.

Arsyetim

Konsumatori në ankesën e tij drejtuar DMK-së në ZRRE me datë 10.02.2010 ka apeluar përgjigjen e KEK Sh.A – Divizioni i Furnizimit – Departamenti për Konsumatorë të datës 29.01.2010 lidhur me kontestimin e ngarkesës së shfrytëzimit të paautorizuar.

- Me datë 28.02.2008 punëtorët e autorizuar të KEK-ut kanë inspektuar pikën matëse dhe kanë larguar njehsorin elektrik nr. 7989559 nga matja e energjisë elektrike dhe kanë vendosur njehsorin elektrik nr. 17712615.
Provë: Vërtetimi i KEK-ut i datës 28.02.2008
- Me datë 19.06.2008 punëtorët e autorizuar të KEK-ut kanë inspektuar pikën matëse dhe kanë larguar njehsorin elektrik nr. 17712615 nga matja e energjisë elektrike dhe kanë vendosur njehsorin elektrik nr. 44935881.
Provë: Procesverbali për ndërrimin e njehsorit elektrik

- Me datë 23.04.2008 punëtorët e autorizuar të qendrës së kalibrimit kanë bërë kontrollimin detal të njehsorit elektrik nr. 7989559, ku është konstatuar se vulat (bllombat) shtetërore janë në rregull, përreth qelqit nga ana e epërme është futur shiriti filmik dhe në brendi të njehsorit ka pluhur të shiritit filmik.
Provë: Procesverbali nr. 31/23 të datës 23.04.2008
- Me datë 13.05.2008 punëtorët e autorizuar të KEK-ut kanë bërë shqyrtimin e njehsorit elektrik nr. 7989559, ku është konstatuar se njehsori elektrik është në kufij të lejuar të matjes së energjisë, nën tension releu tarifor shkakton dridhje.
Provë: Procesverbali mbi shqyrtimin e njehsorit elektrik nr. 3100 të datës 13.05.2008
- Me datë 11.08.2008 punëtorët e autorizuar të KEK-ut kanë inspektuar pikën matëse të konsumatorit dhe kanë bërë regjistrimin e të dhënave teknike të pikës matëse.
Provë: Procesverbali i KEK-ut nr. 0105101 të datës 11.08.2008
- Me datë 19.09.2008 KEK-u e ka ngarkuar konsumatorin me ngarkesë për shfrytëzim të paautorizuar me anë të faturës DPZ08HP04420 në vlerë prej 2,890.27 €.
Provë: Fatura DPZ08HP04420 e datës 19.09.2008
- Me datë 21.04.2009 konsumatori ka parashtruar ankesë në Departamentin për Konsumator në KEK duke kundërshtuar ngarkesën për shfrytëzim të paautorizuar të energjisë elektrike.
Provë: Ankesa e konsumatorit në KEK
- Me datë 29.01.2010 Departamenti për Konsumator në KEK i është përgjigjur konsumatorit duke e refuzuar dhe duke thirrur në procesverbalin e kontrollës dhe të kalibrimit.
Provë: Përgjigja e KEK-ut e datës 29.01.2010
- Me datë 10.02.2010 konsumatori ka apeluar përgjigjen e KEK-ut në DMK të ZRRE-së.
Provë: Ankesa e konsumatorit në DMK të ZRRE-së

Bordi i ZRRE-së ka analizuar Vendimin e lëshuar nga DMK: ZRRE/DMK_V_ 432_07_10 dhe ka konstatuar se vendimi është në pajtim me Rregullat e ZRRE-së. Apeluesi (KEK-u) nuk ka ofruar ndonjë dëshmi shtesë kundër këtij Vendimi, andaj Bordi i ZRRE-së ka vendosur ta **refuzojë** KEK-un për arsyet e paraqitura në vendimin e DMK të ZRRE-së.

Këshillë Juridike: Kundër këtij Vendimi, pala ka të drejtë të iniciojë procedurë gjyqësore në Gjykatën Kompetente, brenda **katërmëdhjetë (14) ditësh** prej ditës së pranimit të këtij Vendimi.

Bordi i ZRRE-së

Dr. Ali Hamiti, kryesues

Theranda Beqiri, anëtare

Përparim Kabashi, anëtar

Blerim Koci, anëtar